**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Idriz Cufaj** | **14.08.2023** | **25.08.2023** | **2023/0570** |
| Eksperti Teknik<br>**Donijeta Sogojeva** | Data e autorizimit të ekspertit teknik<br>**16.08.2023** | | |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.08.2023, OE "ROA Consulting SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0570, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE " Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K., PRISHTINË, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me tre gjeneratorë për nevojat e Komunës së Prizrenit**" me nr. të prokurimit: 622-23-5673-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedur? t? hapur**, lloji i kontrat?s: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **70,000.00€.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së -** Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

**AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së -** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

**AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së -** Kriteret për Dhënien e Kontratës;

**AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së** – Përshtatshmëria e OE

**AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së** – Projektet e realizuar anë vlerë të kërkuar

**Pretendimi 1:** AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave pasi ka shpërblyer me kontratës një Grup të OE i cili ka shumë mangësi në tenderin e tij dhe i njëjti realisht është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm. Mos penalizimi i këtij grupi të OE për gabimet që i posedon në tenderin e tij përbën favorizim të hapur ndaj tij dhe njëkohësisht shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së. Ky veprim përpos tjerash përbën edhe shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së nga ana e AK-së duke tentuar të bëj shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike. Grupi i OE i shpallur fitues ka mangësi në plotësimin e dëshmive lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së, ka mangësi në plotësimin e kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe specifikimit teknik të përcaktuara sipas nenit 69 të LPP-së.
Këto veprime të AK-së përkatësisht të Komisionit të Vlerësimit bien plotësisht ndesh me nenin 1 dhe 6 e veçanërisht me nenin 7 të LPP-së të cilët në asnjë formë nuk ia lejojnë AK-së dhe Komisionit të Vlerësimit të ndërmarrin ndonjë veprim i cili ndikon në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë jo efikase dhe jo transparente dhe nuk ia lejojnë që të bëjnë favorizim të OE të caktuar.

**Pretendimi 2:** AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij neni. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se:

***Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.***

E themi këtë sepse besojmë që Grupi i OE i shpallur fitues ka mangësi të theksuara në tenderin e tij të cilat do të i renditim në vazhdim.

**Mangësia e parë:** AK tek dosje e tenderit kishte kërkuar që OE i cili do përzgjidhet për fitues do të dorëzoj para Njoftimit mbi vendimin e AK-së edhe këto dëshmi:

Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata

tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se **a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për krverjen e një vepre penale;** dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.

Grupi i OE EOR Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K. nuk kishte dorëzuar dëshmitë mbi të shkuarën penale për asnjërin nga drejtorët apo menaxherët e kompanive andaj si i tillë konsiderojmë se nuk e ka plotësuar kriterin dhe kushtin e kërkuar tek pika 6.4 e FDT-së. Pranimi i këtij Grupi të OE si i përgjegjshëm përbën shkelje të plotë të nenit 65 të LPP-së nga të dyja palët dhe njëherit përbënë edhe shkeljet e nenit 59 të LPP-së pasi që nuk janë respektuar kërkesat tilla të dosjes së tenderit.

**Mangësia e dytë:** AK tek pika 9.1 & 9.2 ndër të tjera kishte parashtruar edhe këtë kërkesë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dhe professional** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| | | **Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara ( duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi ) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 100.000,00 €** | **Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të furnizimeve.** |

Grupi i OE ka paraqitur disa kontrata të realizuara por që shumica nga to nuk janë brenda periudhës kohore të kërkuar ndërsa pjesa tjetër e tyre nuk është e natyrës së kërkuar. Përpos kësaj shumica e tyre nuk janë të mbuluara as me referenca adekuate andaj konsiderojmë se ku kriter nuk është plotësuar dhe se Grupi i OE në fjalë është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm. Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit, nuk po i paraqesim secilën referencë dhe dëshmi në formë vizuale por të njëjtat gjinden ne dosjen e ofertës së Grupit të OE të shpallur fitues. Projektet e realizuara që mund të pranohen për nga natyra dhe koha e përfunduar tek lista e Anëtarit të parë të Grupit janë ato nën pikën 33, 37, 40, 41, 50, 65, 66, 67, 72, 77, dhe 79, si dhe vetëm projekti tek pika 1 e listës së projekteve të realizuara

nga Anëtari i dytë i Grupit. Listat e projekteve dhe dëshmitë i gjeni në tenderit e Grupit të OE të shpallur fitues. Shto këtu edhe faktin që për shumicën prej tyre nuk posedon referenca të rregullta. Kjo tregon se ky Grup i OE nuk e ka plotësuar kushtin e kërkuar për projektet e realizuara në vlerën e kërkuar nga AK për çka është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm.

**Mangësia e tretë:** AK kishte publikuar tre dokumente lidhur me kërkesat teknike që do duhej të i plotësonin OE me pajisjet që do aplikonin. Grupi i OE në fjalë nuk ka arritur të i plotësoj specifikimet teknike të kërkuara pasi që ka ofertuar me gjenerator që nuk e plotësojnë pikën 8 të tabelës 2 për secilin gjenerator. Aty është kërkuar që: **Governor Type** të jetë **Elektronik** ndërsa ky grup i OE e ka ofruar **Mekanik.** Ja si ishte kërkesa:

| Governor Type | Electronic |
|---|---|

Ja si e kishte ofruar ky OE:

| | | |
|---|---|---|
| Fuel Consumption 50 % PRP | l/h | 18.5 |
| Lube oil consumption with full load | | <0,5 |
| Total oil capacity including tubes, filters | L | 25 |
| Total coolant capacity | L | 40 |
| Governor | Type | Mechanic |
| Air Filter | Type | Dry |

**Prime Power (PR**
Prime power is
capable of deliver
electrical load wh
per year under th
maintenance inte
prescribed by the
power output (P

Ngjashëm me këtë e ka ofruar për të tre llojet e gjeneratorëve andaj kjo tregon se ky OE është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm.

AK kishte kërkuar që rezervoari i naftës të jetë për gjeneratorin e parë **200 litra** ndërsa për dy të tjerët nga **400 litra.** Ky Grup i OE nuk e ka ofruar ashtu siç janë kërkuar pasi për gjeneratorin e parë e ka ofruar **160 litra,** për të dytin **200 litra** ndërsa për të tretin **350 litra**. Ky kriter nuk ishte plotësuar nga ky grup i OE andaj konsiderojmë se i njëjti është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm.

| CANOPIED | | |
|---|---|---|
| WxLxH | mm | 1080x2850x1600 |
| Weight | kg | 1550 |
| Fuel Tank | lt | 160 |

| CANOPIED | | |
|---|---|---|
| WxLxH | mm | 1130x3100x1610 |
| Weight | kg | 1855 |
| Fuel Tank | lt | 200 |

| CANOPIED | | |
|---|---|---|
| WxLxH | *mm* | 1300x3450x2000 |
| Weight | *kg* | 2500 |
| Fuel Tank | *lt* | 350 |

Ky grup i OE nuk ka arritur të plotësoj edhe shumë specifikime teknike tjera të kërkuara nga AK të cilat eksperti shqyrtues duhet të i verifikoj një nga një. Ne nuk po i cekim të gjitha me radhë sepse del që të bëhet një përshkrim shumë i gjatë i materialit. Pavarësisht atyre, këto dy karakteristika të paplotësuara mjaftojnë që ky Grup i OE të cilësohet i papërgjegjshëm.

Me të gjitha këto mangësi ky Grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ndërsa si OE i përgjegjshëm dhe i renditur si i dyti për nga çmimi, fitues do duhej të shpalleshim ne.

**Pretendimi 4:** AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet paragrafin 1.1 të këtij nenin gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Arsyeja pse mendojmë kështu është se si rezultat i mos vlerësimit si duhet sipas nenit 59 të LPP-së dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit, AK ka shpallur fitues një Grup të OE që posedon çmimin më të ulët por që nuk është i përgjegjshëm. Kjo tregon se pjesa e parë e kriterit të vlerësimit nuk është respektuar. Sipas kësaj me plotë përgjegjësi konstatojmë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar si duhet kriterin e vlerësimit të përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit. Ligjërisht dhe realisht në rastin konkret, fitues do duhej shpalleshim ne.

**Pretendimi 5:** AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe kërkesat që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mungesa e dëshmive kualifikuese, mungesa e certifikatave të ndryshme mbi kualitetin, mungesa e pajisjeve si dhe mangësitë tjera tek tenderi i Grupit të OE të shpallur fitues tregojnë se Grupi i OE nuk është i përgjegjshëm sipas kërkesave të FDT-së dhe sipas nenit 69 të LPP-së andaj konsiderojmë se AK në të njëjtën kohë ka shkelur edhe vet nenin 69 të LPP-së. Mangësitë e këtij grupi i kemi paraqitur më lartë.

**Pretendimi 6:** AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së pasi që Grupi i OE që e ka shpallur fitues nuk ka arritur të dëshmoj se është i përshtatshëm në përputhje me kërkesat e nenit në fjalë. Ky Grup i OE nuk i ka plotësuar kërkesat e pikës 6.4 të FDT-së pasi që nuk ka arritur të ofroj dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë të shkuarën penale për drejtues, menaxher ose drejtor të kompanive që e përbëjnë grupin e OE andaj konsiderojmë se i njëjti grup nuk është i përgjegjshëm.

Nisur nga krejt kjo që sqaruam më lart mendojmë se kemi elaboruar mjaftueshëm shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të pretendimeve tona të merr:

**V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e **Grup i OE "ROA Consulting SH.P.K.; „Auto Grezda Sh.p.k.** lidhur me tenderin "**Furnizim me tre gjeneratorë për nevojat e Komunës së Prizrenit**" i iniciuar nga **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që besojmë se më pas do duhej që **Fitues** të shpallej **Grup i OE "ROA Consulting SH.P.K.; „Auto Grezda Sh.p.k.**

**Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP,** ***janë të njëjta me pretendimet ankimore të parashtruara në Kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar të AK.***

KRITERET PËR VLERËSIM

**Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat e përshtatshmërisë | 6.4 | **Kërkesat e përshtatshmërisë:**<br>**Kërkesat 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov. net** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.** |
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dhe professional**<br>**Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara ( duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi ) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 100.000,00 €** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të furnizimeve.** |

SPECIFIKIMET TEKNIKE

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

**Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:**
**(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).**

**Prizren : 25/7/2023**
**Kontraktuesi :Komuna e Prizrenit, Rr. Remzi Ademaj, Pn**

**Tenderuesi :**
**3. Grup i Operatorëve Ekonomik ROA Consulting SH.P.K.; „Auto Grezda Sh.p.k., Sallabajë-Lluzhan, p.n, 11050, Podujevë**
**5. ELEKTRA L.L.C., rr.Adem Jashari, 71510, Hani i Elezit**
**6. Grup i Operatorëve Ekonomik MULTI ENGINEERING GROUP SH.P.K.; XHM ELECTRIC SH.P.K., Rexhep Krasniqi blloku 5, 10000, Prishtine**

| Nr. i prokurimit: | 622 | 2 | 3 | 1 | 0 | 4 | 1 | 2 | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

**Titulli: Furnizim me tre gjeneratorë për nevojat e Komunës së Prizrenit**

I/e nderuar(a) [Z/Znj]/ :

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj **nuk qe tenderi me çmimin më të ulët** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë : **Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K., Dëshmorët e Ponoshecit, 10000, PRISHTINË ne vlere totale te ofertës 45462.00 Euro.**

Operatori Ekonomik ankues eshte e ofertë e përgjegjshme me çmim më të lartë se Grupi i OE i rekomanduar për kontratë për 3,634.80€.

**GRUPI I OE " Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K." është ofertë e rekomanduar për kontratë**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ROA Consulting SH.P.K.**

Përgjigjet në Pikat e ankesës ndaj Grupit të OE **"Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K."- Prishtinë** të rekomanduar për kontratë.

**Përgjigje në Pretendimi nr.1**

Pretendimi ankimor i OE ankues se është Grupi i Operatoreve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk kanë plotësuar kerkesën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë

Deshmia: 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë para publikimit te Vendimit te AK-së, me date 21/07/2023 ka kerkuar nga Grupi i OE **"Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K."- Prishtinë** sjelljen e dëshmive për Vertetimin e ATK, Vertetim nga Gjykata per Operatorin Ekonomik si dhe Vertetim per drejtuesit, menaxheret ose drejtori i saj. Grupi i OE te rekomanduar per kontrate asnjeri nga anetaret nuk kan dorezuar deshmit **Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale;**

*Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë dhe deshmive te dorëzuara,* mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i OE Ankues është **i bazuar.**

**Përgjigje në Pretendimi nr.2**

Pretendimi ankimor i OE ankues se është Grupi i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk kanë plotësuar **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** në dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë

Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara ( duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi ) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e

kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 100.000,00 €

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të furnizimeve..

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të dorzuara në ofertën e tyre ky Grup i OE kanw dorwzuar listat e kontratave mirwpo nuk kan deshmi te mjashtueshme per kontratat e realizuara qe jane nw listen e kontratave. Autoriteti Kontraktues wshtw dashtur tw kwrkoj sqarime shtese pwr listen e kontratave konform nenit 59.2 dhe nenit 72 si dhe sipas UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve pika 10.1

| **Problemi** | **Si të veprohet?** | **Neni i LPP-së** |
|---|---|---|
| Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara | Mund të kërkohen informata sqaruese | 69 |

*Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë,* mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i pa bazuar.**

**Përgjigje në Pretendimi nr.3**

Ekspertja teknike e vlereson pretendimin ankimore te Grupit te OE ankues (ROA CONSULTING SH.P.K;Auto Grezda Sh.p.k) per te dy rastet si:
- Governor (rregulluesi i shpejtesis) dhe
- Rezervaret e naftes

si te bazuar, sepse oferta e Grupit OE fitues nuk perputhet me kerkesat e specifikimit teknik te lartecekur nga dosja e tenderit.

*Duke ju referuar pretendimit ankimor të sipër permendurë me lartë,* mendimi i ekspertjes teknike është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar nësqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e
OE "ROA Consulting " SH.P.K **të aprovohet si e bazuar** dhe rekomandon **që lendatë kthehet në RIVLERËSIM.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ROA Consulting SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

**Idriz Cufaj**

**Donijeta Sogojeva**

Sogojeva